

SITUATA E EKONOMISË DHE ADMINISTRIMIT TATIMOR SHQIPTAR NË 2010

[Studime mbi tendencën e ekonomisë dhe të ardhurave buxhetore]

22.12.2011

AL-TAX

www.al-tax.org

altax@consultant.com

Tirane, Shqipëri

The **AL-Tax** works to increase public and governmental understanding of issues related to the fairness of Albanian's economic-fiscal and social system and the stability and adequacy of state and local public services.


The primary purpose is to promote education in taxation, help and assist them with the proper expertise and protect from abusive actions from public administration. One of our key aims is to achieve a more efficient and less complex tax system for all. Our comments and recommendations on tax issues are made solely in order to achieve this aim; we are an entirely apolitical organisation.

1. Prodhimi i Brendshem, bizneset ne shqiperi sipas grup aktiviteteteve

1.1. Prodhimi i brendshem dhe struktura

Nga te dhenat e publikuara nga Banka Boterore, Prodhimi i Brendshem Bruto (PBB) ne Shqiperi ne vitin 2010 eshte ne shumen 2.553 miliard leke (23.86 miliard dollare amerikane, 1 US.D=107 leke). Nderkohe te dhenat e INSTAT per 2009, e perlllogaritur me rritjen ekonomike te 2010 mendohet te jete sa gjysma e kesaj vlere me lart.

Sipas publikimit te Ministrise se Financave, struktura e Prodhimit te brendshem eshte i ndare ne sherbime dhe tregti (pa transportin) me 58% te ekonomise, 17.5 % eshte pjese e sektorit agrolegtoral, 9.9 % eshte industri, 9.4% eshte ndertim dhe 5.2% eshte transport.



1.2. Struktura e biznesit

Mbeshtetur ne te dhenat me lart edhe pesha e aktiviteteteve te regjisruara duhet te eci nen kete tendence dhe strukture.

Sipas regjistrit të bizneseve në Shqipëri afërsisht veprojnë në mënyrë aktive dhe të regjistruar si biznese pasive një numër prej 120,000 të regjistruarish në nivel vendi.

Në tabelën më poshtë shikohet peshën kryesore të aktiviteteve të mban sektori i tregtisë me 42.9%, i ndjekur nga shërbimet me 29.7%, prodhimi me 13.5%, transporti me 9.5% dhe ndërtimi me 4.4%. Gjithashtu, në strukturën e aktiviteteve në ekonomi përfshihen edhe organizatat jofitimpruese, të cilat në strukturën e tabelës zënë 1.4% dhe së bashku me organizatat që kanë status diplomatik zënë 1.5% të numrit të aktiviteteve ekonomike sipas natyrës së aktivitetit të tyre.

Struktura e shpërndarjes së bizneseve sipas qarqeve në Shqipëri

ne %

Nr.	Qarku	Sektoret e ekonomisë*							Aktivitete shoqëror		Totali organizata	TOTAL QARKU
		Prodhim	Shërbim			Tregti	Ndërtim	Transport	OJF	Organizata të huaja dhe diplomate		
			Fjetje, ushqim	Te tjerat	Totali							
1	Berat	14	8	16	24	52	3	7				100
2	Diber	13	14	14	28	37	4	18	1		1	100
3	Durrës	11	18	13	31	42	5	11				100
4	Elbasan	15	13	15	28	41	3	13	1		1	100
5	Fier	14	13	13	26	46	4	10				100
6	Gjirokastër	17	13	17	30	39	4	10	1		1	100
7	Korçë	14	12	14	26	45	3	12	1		1	100
8	Kukës	16	13	17	30	38	6	10	3		3	100
9	Lezhë	15	14	15	29	42	6	8	1	0.03	1.03	100
10	Shkodër	12	16	14	30	46	3	9	1	0.01	1.01	100
11	Tiranë	9	16	23	39	43	6	3	3	0.3	3.3	100
12	Vlorë	12	21	14	35	44	6	3	1	0.03	1.03	100
Gjithsej		13.5	14.3	15.4	29.7	42.9	4.4	9.5	1.4	0.1	1.5	100

Burimi i informacionit: QKR, Botime mbi OJF në Shqipëri

* Gabimi në grupim dhe llogaritje është në kufirin e shmangies 2% - 4%

Nga krahasimi midis peshës së sektorëve ekonomikë në PBB dhe peshës së sektorëve ekonomikë sipas regjistrit të bizneseve, për grupin “Shërbime dhe Tregti” të ketë një peshë më të lartë se pesha e sektorit në PBB për 12 pikë përqind më të lartë. Nëse referenca e peshës së PBB-së konsiderohet si statistika bazë e besueshme atëherë, regjistri i bizneseve për këtë sektor

tregon se egziston mundësia e aktiviteteve të regjistruara, por me pasaktësi të kodit ekonomik dhe mospërputhje me numrin e aktiviteteve në realitet.

Nisur nga ky krahasim më lart, mundësia për shmangie mundet të jetë edhe në sektorët e tjerë.

Nisur nga pesha specifike që zë në strukturën e aktiviteteve në vend, sektori tregtar me 43%, i ndjekur nga sektori i shërbimeve me 30%, si dhe në vijimesi nga prodhimi, transporti dhe ndertimi, janë burimet për arritjen e targeteve për të ardhurat fiskale, tregtine me jashtë dhe brenda, punësimin duke shërbyer si objekt programimi nga institucionet që lidhen me prognoza dhe programe të ardhurash dhe përfitimesh.

1.3. Analiza e kostos, cmimeve dhe disa tendenca të sektoreve ekonomike

1.3.1. Ndertimi dhe shitja e objekteve dhe punimet e infrastruktures

Nga të dhënat për ndertimin, në 2010 ka një rritje të shitjeve të sipërfaqeve (të përjashtuara nga TVSH) me 4% dhe një ulje të volumit të punimeve ndertimore me 23% me pak se 6 muhori 2009. Nisur nga ky realitet, si dhe duke marrë në konsideratë vitin 2010, kur nuk pati miratime të shumta të lejeve të ndertimit të objekteve civile, efekti i tij në të ardhurat fiskale ra me të paktën 6 %.

1.3.1.1. Kostot e punimeve ndertimore

Krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2009 Indeksi i Kushtimit në Ndërtim ka shënuar një rritje me 0.1 përqind. Një vit më parë ky ndryshim ishte 0.9 përqind.

Indeksi i çmimeve të grupit "Shpenzime direkte" është rritur 0.2 përqind kundrejt tremujorit të mëparshëm.

Indeksi i nëngrupit "Shpenzime materiale" është rritur me 0.3 përqind. Cmimet e materialeve të ndërtimit dhe materialeve elektrike janë rritur përkatësisht me 0.3 dhe 0.5 përqind. Gjithashtu rritje kanë pësuar dhe indekset në nëngrupet "Shpenzime transporti" dhe "Shpenzime makinerie" përkatësisht me 0.6 dhe 0.2 përqind. Sipas INSTAT, në punimet ndertimore pati një rritje në vijimesi të kostos së ndertimit, ku ndikimi kryesor ishte nga transporti, i cili me futjen e normave të akcizës për naftën dhe futjen e akcizës për gomë pneumatike pati një ndikim me të paktën 5% rritje të cmimit të transportit krahasuar me vitin e kaluar. Nderkohe, lidhur me

efektin e kostos ne ndertim ne te ardhurat tatimore diskutimi me Shoqaten e Ndertuesve te Shqiperise mbi koston minimale fiskale mbeti i parealizuar. Per punimet e infrastruktures me fonde publike nuk ka ndryshim te cmimeve.

Ne lidhje me punimet ndertimore civile dhe per banesa, sipas studimit te fundit te kryer nga Sektori i Standartizimit te Kostos ne Ministrine e Puneve Publike dhe Transporteve, jane vendosur kufijte per cmimet e transportit ne rreth 30 leke per ton/km, cmimet e materialeve dhe lendeve te para ndertimore, te cilat jane evidentuar nga investigime te tregut te kryera nga specialistet e kesaj ministrie, si dhe kane perlllogaritur nje mesatare per shpenzimet e pergjithshme ne nivelin 8% te vleres se pergjithshme te koston, perpara aplikimit te normes se fitimit dhe tatimit te vleres se shtuar. Ky studim u be pjese e nje Manuali Teknik, pjese e bashkepunimit te te cilit eshte edhe Ministria e Financave.

1.3.1.2. Çmimet e shitjes se siperfaqeve te objekteve nga sektori privat

Me poshte, sipas burimeve te informacionit te agjensive imobiliare te zonave respektive tendenca e tregut te shitjeve eshte si me poshte :

Durrës. Çmimet minimale janë ulur 50-70 euro/m², d.m.th nga 550 euro/m² kanë shkuar në 500-480 euro/m², ndërkohë që rënie ka pasur edhe në çmimet maksimale të apartamenteve në Plazh. Nga 900 euro/m² që kanë qenë çmimet maksimale në këtë zonë, kryesisht në vijën e parë të Bregdetit, sot ato shiten me 700- 750 euro/m². Ky ndryshim nuk ka ndodhur ne fashtarat turistike dhe zonat e reja te plazheve publike, si: Gjiri i Lalzit etj., ku cmimet e shitjes jane ne rritje me 1000 euro/m².

Vlorë. Çmimet në qytetin e Vlorës variojnë në bazë të zonës, ku më i ulëti nga 650 euro/m² që ishte në 2009-n është reduktuar në 550 euro/m², ndërsa çmimi më i lartë nga 1200 euro/m² shitet me 1000 euro/m².

Tiranë. I vetmi qytet që nuk ka ulje të çmimeve të apartamenteve është Tirana. Me gjithë ofertën e lartë dhe kërkesën e reduktuar, Tirana dhe periferite e saj vijojne të ofrojnë të njëjtat çmime si një vit më parë.

1.4. Prodhimi per tregtim brenda vendit dhe per eksport

Subjektet qe kryejne aktivitet prodhimi kane deklaruar nje rritje te xhiros ne 6 mujorin 2010 krahasuar me 2009 me nje rritje te pergjithshme prej 15%, por qe peshen kryesore ne kete rritje e zene subjektet e eskportit me nje xhiro te deklaruar prej 2 here me te larte se 6 mujori 2009. Nje rritje e xhiros ne kesaj sektor, nese shikojme edhe rritjen e qarkullimit te eksporteve ndikon ne rritjen e arketimeve te TVSH nga ky sektor. Kjo rritje ka ardhur nga prodhimi I pijeve alkoolike, birres dhe pijeve freskuese, prodhimit te naftes, si dhe prodhimit te energjise.

Ne subjektet e prodhimit, peshen kryesore ne te ardhurat tatimore e zene kompanite industrise nxjerrese, industria energjitike si dhe industria e prodhimit per eksport, e cila ka nje peshe prej mbi 30% ne nivel kombetar te kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore.

1.4.1.1. Industria nxjerrese

Numri i bizneseve te regjistruar ne QKR ne industrine nxjerrese, 2010

numer

Nr.	Qarku	Industria e nxjerrjes dhe perpunimit te mineraleve					Totali
		Qymyrgur	Nafte dhe gaz	Uranium dhe Torium	Minerale metalike	Minerale ndertim	
1	Berat	2	2		2	38	44
2	Diber	18	3		55	11	87
3	Durres	2	3		4	51	60
4	Elbasan	2			4	14	20
5	Fier	1	8			18	27
6	Gjirokaster				2	24	26
7	Korce	8			8	12	28
8	Kukes	5			15	7	27
9	Lezhe				1	23	24
10	Shkoder		2	1	2	27	32
11	Tirane	20	33	1	35	64	153
12	Vlore	16	3		1	32	52
Gjithsej		74	54	2	129	321	580

Burimi i informacionit : QKR


Sipas te dhenave nga Ministria e Ekonomise, Tregtise dhe Energjitikes (METE) janë dhënë 738 leje minerare, nga të cilat, leje minerare shfrytëzimi 580. Numri më i madh i lejeve i takon rrethëve: Bulqizë, Krujë, Tiranë, Vlorë, Tropojë.

Numri i lejeve minerare dhene ne Shqiperi, 2010

Nr.	Emertimi mineralit	Numri dhe shperndarja e lejeve	
		Numer	ne %
1	Krom	220	30%
2	Hekur-Nikel	30	4%
3	Gure gelqerore	259	35%
4	Mermere	15	2%
5	Baker	17	2%
6	Qymyrgur	5	1%
7	Bokside	2	0.3%
8	Kuarc	5	1%
9	Gips alabaster	11	1%
10	Argjila	35	5%
11	Gure dekorative	38	5%
12	Ranore pllakore	26	4%
13	Plagjiogranite	2	0.3%
14	Te tjera	73	10%
Gjithsej		738	100%

Burimi i informacionit: AKBN

Nga totali prej 738 leje minerare, për mineralin e kromit janë dhënë 220, për hekur-nikel dhe nikel-silikat 30, për gurë gëlqerorë 259, për gëlqerorë të mermerizuar 15, për mineral bakri 17, për qymyrgur 5, për baokside 2, për kuarc 5, për gips alabastër 11, për argjila 35, për pllaka gëlqerore të trashësive të ndryshme 38, për ranorë pllakorë 26 dhe për plagjiogranite 2. Pjesa tjetër e lejeve i takon llojeve shkëmbore si rëra kuarcore, ranorë, shiste, rëra e zhavorre bituminoze, bazalte, shkëmbinj ultrabazikë, etj.



1.4.1.1.1. Zonat kryesore, subjektet qe operojne dhe kerkesat per monitorim fiskal

Ne paragrafet me poshte, jane prezantuar zonat kryesore me minerale.

Kromi

- Bulqiza, operon Albanian Chrome shpk, e cila zoteron edhe nje furnnalte ne Elbasan. Kjo shoqeri zoterohet nga DCM Deco Metal GmbH (austri). Ne 2008 prodhoi 74,674 metra kub krom dhe 11,916 metra kub ferrokrom, nepermjet furnnaltes, e cila ka nje kapacitet prej 15,000 metra kub. Per kete zone ka marre kater licensa shfrytezimi edhe Empire Mining Corporation (Kanada), por pa filluar ende nga pordhimi.
- Kuksi, ka perfunduar projektin operatori Jab Resources Ltd (Australi) qe synon te ndetoje nje fabrike perpunimi me kapacitet 700000 metra kub.
- Tropoja
- Shebenik, Pogradec

Sektori i kromit ka:

- Disa operatore nderkombetare me te drejta hyrje te besueshme ne informacionet financiare te tyre
- Operatore te vegjel dhe te mesem, qe nuk kane besueshmeri ne informacionet financiare
- Monitorim mjaft i kufizuar i cmimeve nderkombetare te tregut.

Ky sektor eshte mjaft i veshitre per tu monitoruar, duke patur parasysh se cmimet e kromit nuk jane te kuotuar ne tregjet nderkombetare. Kjo mungese informacioni ndikon si mbi insitucionet qe e kane te nevojshem informaconin, por edhe mbi operatoret e vegjel dhe te emsem qe kane nevojpe te dine cmimin perpara se t'ja shesin ndermjetesit per ta eksportuar, qe per shumicen prej tyre eshte Albanian Chrome. Disa prodhues dalin drejtperdrejt ne tregun nderkombetar.

Bakri

Shqiperia eshte prodhuesi me i vogel i bakrit ne Ballkan. Ne 2008 u prodhua 70,000 metra kub baker. Cilesia e bakrit shqiptar eshte mesatare, e lidhur me koncentrimin ne mineral. Nisur nga

depozitat qe ka ne vend, sipas Bankes Boterore ka mundesi qe te kthehet ne nje prodhues te nivelit boteror, po te shfrytezohet dhe investohet ne kete sektor prodhimi.

Zonat kryesore jane:

- Munella, operon “Ber Oner” (Turqi), i cili prodhon 70,000 metra kub, qe e eksporton te shoqeria “person i lidhur” me te ne Turqi.
- Lakroshi
- Karma
- Perlati, ku ka 5 leje shfrytezimi operatori “Balkan Resources Inc.” (Kanada). Kjo zone eshte e pasur ne mineral bakri.
- Spaci
- Bregu i Geshtenjes
- Mirdita, ku ka leje shfrytezimi operatori “Tirex Resources Ltd” (Kanada), por pa filluar ende prodhimin. Kjo zone ka depozita te medha minerali bakri, argjendi dhe ari.

Ky sektor perfshin operatore te nivelit rajonal dhe jo i besueshem ne te dhenat dhe informacionin financiar. Disa investime te huaja jane ende ne nivele te vogla. Cmimi per kete mineral jane te monitorueshme ne tregun nderkombetar, por me nje kufizim ne verifikimin e kostove te cmimeve te tregut nderkombetar. Nisur nga ky kuader, kontrollet per transferimin e cmimit ne kete sektor jane te nevojshme te kryhen rregullisht duke krijuar nje tradite ne monitorimin e sektorit.

Nikel

Rezervat e nikelit jane afer 300,000 metra kub dhe kjo industri perben potencialin me te madh per Shqiperine. Ky sektor eshte i dominuar nga operatore te vegjel dhe te mesem vendas me nje prodhim te perbashket vjetor prej 400,000 metra kub. Ky prodhim eksportohet ne maqedoni, Kosove dhe Greqi.

Zonat kryesore jane:

- Has, Kukes, Lure
- Librazhd, Pogradec

- Devoll, e cila operohet nga “Balkan Resources Inc.” (Kanada) dhe “European Nickel Plc” (Britania e madhe). Keta operatore synojne te prodhojne 15 deri 20,000 metra kub ne vit, per 15 vite rrjesht.

Ky sektor perfshin operatore vendas te vegjel dhe te mesem. Marrja e te dhenave eshte e kufizuar dhe jo te besueshme informacionet financiare. Investime te huaja ne nivele te vogla. Cmimi per kete mineral jane te monitorueshme ne tregun nderkombetar, por me nje kufizim ne verifikimin e kostove te cmimeve te tregut nderkombetar.

Nisur nga ky kuader, kontrollet per transferimin e cmimit ne kete sektor jane te nevojshme te kryhen rregullisht duke krijuar nje tradite ne monitorimin e sektorit.

Cmimi i ketij minerali mund te monitorohet sipas treguesve te cmimeve te tregjeve nderkombetare. Duhet krahasuar sasia dhe cilesia me keto cmime per prodhuesit vendas. Edhe ky sektor keshillohet per te njejten metodologji si per sektoret e tjere.

Komente per gjithë industrinë

E gjithë industria nxjerrëse dhe përpunuese e naftës dhe mineraleve ka mangësi të kontrolleve prej institucioneve, të cilët konsiderohen të dobët dhe të kufizuar në objektin e tyre.

Kjo dikton nevojën për kontrolle të plota, si dhe specialiste që njohin:

- nivelin e investimeve, si dhe rezervat minerare dhe kapacitetet
- tipin e aktivitetit dhe teknologjisë
- njohjen e vlerësimit dhe përfitimeve të lejeve të dhëna
- njohjen dhe zbatimin e rregullave që lidhen me shmangien e tatimoreve dhe rrjedhojat e zbatimit të transferimit të cmimit

Shumica e shoqërive të lidhura me shoqëritë që operojnë në industrinë nxjerrëse janë të listuara në bursat e tregjeve nderkombetare, të vendeve ku shoqëritë nderkombetare janë të regjistruara. Prezenca në këto bursa tregon për standarte të mirëfillta të zbatimit të rregullit të këtyre tregjeve, që përfshijnë informacione për publikun, të besueshme, dhe të pamaniplueshme.

Identifikimi i paleve te lidhura

Kontrolli i elementeve qe mund te perfitohet kur zbatohet transferimi i cmimit fillon me identifikimin e paleve te lidhura potenciale, qe mund te japin sherbime per operatoret ne Shqiperi me cmime te egzagjeruara. Shumica e operatoreve ne Shqiperi japin informacion te lidhur me personat e lidhur me ta.

Liçensë-Marrëveshjet për Zhvillimin dhe Prodhimin e Hidrokarbureve për vendburimet ekzistues të naftës dhe gazit, dhënë Albpetrol-it:

a. Liçensë-Marrëveshja për vendburimin e Patos-Marinzës, dhënë në vitin 2004.

Kontraktor Bankers Petroleum;

b. Liçensë-Marrëveshja për vendburimin e Ballsh-Hekalit, dhënë në vitin 2007.

Kontraktor Stream Oil & Gas;

c. Liçensë-Marrëveshja për vendburimin e Cakran-Mollajt dhënë ne vitin 2007.

Kontraktor Stream Oil & Gas;

d. *Liçensë-Marrëveshja* për vendburimin e Gorisht-Koculit, dhënë në vitin 2007.

Kontraktor Stream Oil & Gas;

e. *Liçensë-Marrëveshja* për vendburimin e Delvinës dhe bllokun e kërkimit të Delvinës, dhënë në vitin 2007.

Kontraktor Stream Oil & Gas;

f. *Liçensë-Marrëveshja* për vendburimin e Kuçovës, dhënë në vitin 2007.

Kontraktor Shervood International.

g. *Liçensë-Marrëveshja* për vendburimin e Visokës.

Kontraktor kompania "IEC Visoka".

Kerkim nafte

Bloku „Durrresi“ ne det - Island Oil&Gas dhe Beach Petroelum

Blloku “Joni -5” ne det - MedOil.

Bllloqet “A & B” ne toke - DËM Petroleum AG.

Bllloqet “D & E” ne toke - DËM Petroleum AG.

Industria e nxjerrjes dhe perpunimit te naftes paguan per nje vit afersisht 21 deri 31,5 miliarde leke (200 deri 300 milione dollare amerikane, 1 US.D=105 leke) detyrime tatimore dhe doganore;

Industria e nxjerrjes dhe perpunimit te mineraleve (Krom, baker, nikel, lende bituminoze) paguan afersisht per nje vit 8,4 deri 10,5 miliarde leke (80 deri 100 milione dollare amerikane, 1 US.D=105 leke) detyrime tatimore dhe doganore.

Sipas studimit te kryer nga Banka Boterore lidhur me industrine minerare dhe te nxjerrjes dhe prodhimit te naftes, qe trajton ceshtje te transferimit te cmimit ne lidhje me keto industri, me qellim zbatimin e Iniciatives per Transparence te Industrive Nxjerrrese (EITI) rezulton se:

- Ky sektor ekonomik perfshin operatore ekonomik te shoqerive nderkombetare dhe eshte i hapur ndaj tregjeve nderkombetare;
- Barra tatimore per operatoret ne kete sektor eshte nje element per tu trajtuar me vemendje nga administrata tatimore dhe doganore pasi perben objekt per evazion tatimor qe lidhet me problemet qe vijne nga transferimi i cmimit.

Problemet kryesore te lidhura me transferimin e cmimit jane:

- Rritje e shpenzimeve duke u transferuar nga shoqeria e lidhur me shoqerine qe operon ne Shqiperi dhe ulje te fitimit qe sjell renie te tatimit mbi fitimin;
- Mosdeklarim korrekt te cmimeve te shitjes, te cilat i transferohen nepermjet eksportit shoqerise se lidhur jashte Shqiperise dhe duke ulur ne kete menyre fitimin dhe tatimin mbi fitimin dhe rentes minerare.
- Mungesa koordinimit midis institucioneve (Agjensia Kombetare e Burimeve Natyore, DPT, DPD) eshte arsyeja e forte qe rrisqet qe vijne prej transakcioneve te transferimit te cmimit nuk jane adresuar dhe kryer si duhet. Ne kete kontekst, kontrollet qe duhet te kryhen ne keta operatore duhet te jene gjithperfshires, te plote dhe sipas parimeve te EITI.

Kostot e aktivitetit te rritura ne menyre te egzagjeruar

- Konsulence teknike e huaj me shume nga sa eshte e nevojshme;

- Cmime te egzagjeruara ne importe te materialeve;
- Cmime te egzagjeruara te transportit nderkombetar;
- Kosto te zyres qendrore te shoqerise nderkombetare te shkarkuara te filiali;
- Kosto te kerkimeve dhe zhvillimeve, qe kane natyre te veshtire per te matur efektin direkt ne te ardhurat e filialit.

Aplikim i cmimeve te shitjes nen vleren e tregut nderkombetar

- Cmime shitje poshte cmimit te tregut;
- Kosto te egzagjeruara te shitjes apo transportimit ne destinacion.
- Mosdeklarim i sasise se sakte te shoqeria e lidhur

Fushat naftembajtese kryesore jane:

1. Patos, Marinez, Kolonje (51%), operon Bankers petroleum Ltd, e cila aktualisht prodhon rreth 7000 fuci ne dite
2. Delvine (20%), operon Stream oil and gas.
3. Cakran, Mollaj (10%), operon Stream Oil and Gas. Per te dy zonat prodhon rreth 2500 fuci ne dite.

1.5. Nafta, gazi i lengshem. Struktura e tregut, cmimet dhe efekti ne te ardhura sipas konsumit

1.5.1. Kapacitet depozituese

Kapacitetet depozituese bregdetare të naftës dhe benzinës

Nr	Emri shoqërisë	Kapaciteti depozitues	Vendodhja
1	Petrolifera Italo Albanese	40,700 m ³	Vlorë
2	Kastrati	30,000 m ³	Porto Romano
3	ARMO	30,000 m ³	Vlorë
4	Uldedaj	28,320 m ³	Shëngjin
5	Europetrol Durrës Albania	28,000 m ³	Porto Romano
		4,400 m ³	Ura Dajlanit, Durres
6	Taci Oil	22,000 m ³	Porto Romano +Shengjin
7	Porto Romano Oil	14,000 m ³	Porto Romano
8	Evroil sha (jo në punë)	10,900 m ³	Durrës
9	Global Petroleum Albania	12,000 m ³	Durrës
10	Mamidoil Albania	12,000 m ³	Durrës
11	Viloil	8,500 m ³	Shëngjin
Totali		240,820 m³	

Shoqëria Europetrol Durrës Albania sha ka mbaruar ndërtimin në Porto Romano te dy depozitave nga 5,000 m³ secila për solar dhe bitum. Gjithashtu, shoqëria Anoil sha ka filluar ndërtimin e depozitave bregdetare në Porto Romano, mbas marrjes së lejes nga Këshilli Ministrave.

Eksistojnë dhe disa shoqëri të tregtimit me shumicë, si Rira sha, Klodi sha, Alpin sha, Anoil sha si dhe Fit Mek Oil sha, të cilat disponojnë depozita jo bregdetare me kapacitete të vogla, që ndodhen në zonën e qarkut të Tiranës.

1.5.2. Kapacitetet depozituese bregdetare të GLN

Pjesa më e madhe e kapaciteteve depozituese jo bregdetare janë instaluar në zonën Tiranë – Durrës, si:

- “Fix Gas” dhe “API Gas” të vendosura në zonën e Kombinatit, Tiranë me kapacitete depozituese mbi 300 m³ secila.
- “Mare Oil” me kapacitet depozitues prej 500 m³, me një impiant të ri të ndërtuar në Prezë, rruga dytësore Tiranë-Durrës. Kjo shoqëri zotëron gjithashtu kapacitete depozituese prej rreth 1200 m³ në Fier.
- “Dua Gas”, “Sofi Gas”, “Bako Gas”, “BUTAN Gas” dhe “VJOSA” me kapacitete depozituese, që variojnë nga 200 m³ deri 500 m³ secila.

Në zonën juglindore operojnë 4-5 shoqëri ndër të cilat përmendet “Top Gas” me kapacitet depozitues të ri rreth 300 m³.

Nr	Shoqëria	Kapaciteti depozitues	Vendodhja
1	Intergaz	10,000 m ³	Porto Romano
2	Petrolifera Italo Albanese	4,400 m ³	Vlora 1
Totali		14,400 m³	

Primagas Albania sha zotëron kapacitete depozituese në Fier dhe Durrës prej 3,600 m³. Kjo shoqëri, projektton të ndërtojë depozitë të re në Porto Romano me një kapacitet prej 4,000 m³. Gjithashtu dhe shoqëria Kalaja Gaz pritet të zhvendoset në Porto Romano. Kjo shoqëri ka depozita aktuale në qytetin e Vlorës me një kapacitet prej rreth 1,000 m³.

Totali i prodhimit të brendshëm të naftës bruto	000/ton								
	2001	2002	2003	2004	2005	2006	2007	2008	2009
	329	350	399	399	448	518	563	577	560

Rritja i dedikohet kryesisht rritjes së prodhimit në fushën e Patos Marinzës nga Bankers Petroleum. Kjo shoqëri ka si objektiv të saj që të rrisë prodhimin në rreth 14,000 bod naftë bruto deri në fund të vitit 2010. Pjesa më e madhe e prodhimit të saj eksportohet në Itali dhe vetëm një pjesë e vogël i shitet Albpetrolit, shoqërisë shtetërore të nxjerrjes së naftës.

Shoqëria ARMO realizon përpunimin total të prodhimit vendas të naftës në dy rafineritë që ka në aktivitet (nga 4 rafineri që ka pasur në punë): Kombinati i Përpunimit të Thellë të Naftës (KPTHN) Ballsh dhe Uzina e Përpunimit të Naftës (UPN) Fier. Kapaciteti i rafinerisë së Ballshit është 1,000,000 tonë / vit kurse ai i Fierit është 500,000 tonë / vit, por punojnë me një kapacitet punë deri në 30% për mungesë të lëndës së parë dhe gjendjes teknike të amortizuar të tyre. Rafineria e Fierit prodhon kryesisht solar & mazut si dhe bitum, ndërsa rafineria e Ballshit prodhon ciklin e plotë të nënprodukteve si benzinë, vajguri, diezel, solar, koks, mazut dhe gaz të lëngëzuar.

1.5.3. Importi i naftes

Burimi kryesor i importit të nënprodukteve të naftës është Greqia, me rreth 50% të totalit të importeve (viti 2008). Greqia zë vendin e parë të importeve, pastaj është Rusia me 22%, Gjeorgjia me 6% dhe Kroacia & Italia me 4%. Me poshte eshte struktura e karburanteve qe importohen.

Emërtimi	Njësia Matjes	Viti 2008
Benzinë	ton	0
Eurodiezel	ton	34
Diezel	ton	69
Solar & Mazut	ton	1,933
GLN	ton	3,572

Bazuar në konsumin e vitit 2009, rezulton që sektori i transportit ka konsumuar rreth 69,5% të produkteve të naftës, sektori i industrisë 12%, sektori i bujqësisë përfshirë dhe peshkimin ka konsumuar 9%, shërbimet 4% dhe sektori i banesave ka konsumuar 5,5% të produkteve të naftës.

Gazi i lëngshëm i Naftës (GLN) në vendin tonë, ka rritur në mënyrë të ndjeshme prezencën dhe po luan një rol gjithmonë e më të madh në tregun vendas, si burimi energjetik alternativ më i mundshëm për të zëvendësuar energjinë elektrike në sektorin e banesave dhe shërbimeve, duke u konsumuar kryesisht për ngrohje dhe gatim. Konsumi i GLN në vitin 2008 arriti në një total prej 83 ktoe. Një përdorim gjithmonë e më të gjerë kjo lëndë energjetike po gjen në industrinë ushqimore dhe atë të ndërtimit

Përdorimi i gazit të lëngshëm nga automjetet është akoma në nivele tepër të ulëta, kryesisht ky produkt përdoret për sektorin shtëpiak.

ne ton

Nr	Emri	Konsumi i përafërt viti 2008
1	Termocentrali Vlorë sha	30,000
2	Administrata shtetërore	15,000
3	Bechtel - Enka	25,000
4	Shoqëri ndërtimi rrugësh	10,000
5	Bankers Petroleum Albania	7,000
6	AMC + Vodafone	3,000
Totali		90,000

Pjesët e tregut të shoqërive kryesore importuese dhe të shitjes me shumicë të dieselit

Nr	Shoqëria	2009
1	Taçi Oil International sha	24.77%
2	Kastpetrol sha	24.64%
3	Europetrol Durrës Albania sha	22.92%
4	Mamidoil Albanian sha	6.50%
5	Global Petroleum Albania sha	6.18%
Koefiçienti Përqëndrimit CR 5		85.02%

Burimi: Autoriteti Konkurrencës, Vendimi nr 117, datë 29.05.2009

Në vitin 2009, shoqëria Taçi Oil sha ishte lider në tregun e dieselit me 24.77%, duke u ndjekur nga Kastpetrol sha dhe Europetrol Durrës Albania sha. Shoqëritë greke kishin rënie të pjesës së tregut duke arritur së bashku në vetëm 12.68% të tregut. Vlerësohet se pjesa e tregut të shoqërisë ARMO në vitin 2009 për produktin diesel ishte 23%.

Pjesa e tregut të shoqërive kryesore në bazë të të ardhurave për periudhën 2009 - 2010 në %

Nr	Shoqëria	Pjesa e tregut në bazë të të ardhurave	
		2008	2009
1	Kastpetrol	20	20
2	Taci Oil International	17	16.2
3	Europetrol Durrës Albania	11	14
4	Viloil	13	13
5	Global Petroleum	10	10
6	Mamidoil Albanian	5	6
Totali		76%	79.20%

Burimi: Autoriteti i Konkurences

Shoqëritë kryesore të tregtimit me shumicë të karburanteve kanë pasur pothuajse të njëjtën pjesë tregu, sipas të ardhurave të tyre në vitet 2008-2009. Në tabelën me lart, shikohet qartë mbizotërimi i tre shoqërive shqiptare dhe asaj turke, të cilat kane 63% të tregut të karburanteve në Shqipëri. Arsyeja kryesore është agresiviteti i treguar i këtyre shoqërive në ndërtimin e rrjeteve të tyre të tregtimit me pakicë të karburanteve, duke u shndërruar kështu me sukses në shoqëri të integruara vertikalisht. E njëjta strategji propozohet për çdo shoqëri që synon të penetrojë në tregun shqiptar të tregtimit me shumicë të karburanteve.

Në tregun e GLN-së, shoqëria Primagas Albania sha është lider me rreth 40%, e ndjekur nga Kalaja Gas sha dhe shoqëritë e tjera. Vlerësohet se gjithashtu shoqëria e re Intergas sha do të jetë lider në treg për shkak të pozitës së saj strategjike në Porto Romano.

Shumica e stacioneve të shitjes me pakicë të karburanteve janë përqëndruar në rajonin Tiranë-Durrës si dhe në qytetet e Fierit dhe Vlorës, rreth 50% e numrit total sipas të dhënave të AKBN.	Numri i shoqërive të tregtimit me pakicë që operojnë në tregun e nënprodukteve të naftës				
	Emertimi	2006	2007	2008	2009
	Shoqëri të shitjes me pakicë*	1,030	990	1,000	1,035
	Stacione të shitjes me pakicë	975	990	1,000	1,035

* shoqëria ka disa stacione shitje me pakice

Burimi: METE

Stacionet e shitjes me pakicë të GLN janë të pakta në numër, rreth 150 në të gjithë vendin. Shitja e GLN realizohet gjithashtu në stacionet e shitjeve me pakicë të karburanteve (lejohet vetëm tregtimi për makina) dhe në pika shitjeje me artikuj të përzierë (në mënyrë krejtësisht të jashtëligjshme me legjislacionin e fushes specifike).

Përhapja e shoqërive kryesore të tregtimit me pakicë të karburanteve			
Nr	Emri	Numri pikave	Komente
1	ALPET + EXEN	103	Rritje e vazhdueshme
2	TAÇI OIL	100	Rritje e vazhdueshme
3	KASTRATI	40	Rritje e qëndrueshme
4	EIDA	40	Rritje e qëndrueshme
5	JET OIL	40	Qëndrueshmëri
6	ULDEDAJ	20	Qëndrueshmëri
7	ANOIL	25	Qëndrueshmëri
8	EKO	12	Ndalim investimesh
9	BRAKA OIL	7	Rritje e ngadaltë
10	API	11	Ndalim investimesh
11	RIRA	20	Rënie e vazhdueshme
12	EURODRIN	20	Stacionet me qera
13	ARMO	25	Në privatizim e sipër
14	PETROLIMPEX	12	Stacionet me qera
15	FISHEKU	5	Gjendje e keqe
Totali		480	

a) Çmimet e transportit nga importi

Duke pasur parasysh se anijet që vijnë në Shqipëri janë të tonazhit të ulët, rreth 2,000 – 3,000 tonë, çmimet e transportit nga Greqia janë relativisht të larta dhe variojnë si më poshtë:


- Me anije: 2,625 – 2,835 Leke / ton
- Me autobot: 5,250 Leke / ton

b) Marzhet e fitimit për shumicën

Marzhet e fitimit të shoqërive të shitjes me shumicë variojnë nga:

- Diezel: 3 – 4 lek/litër
- Eurodiezel: 4 – 5 lek/litër
- Benzinë: 5 – 6 lek/litër
- GLN: 4 – 5 lek / kg

1.5.4. Kosto dhe çmimi i shitjes me shumicë i diezELIT (2009)



Burimi: Shoqëri e shitjes me shumicë

Marzhet e fitimit per pakicen

Marzhet e fitimit të shoqërive të shitjes me pakicë variojnë nga:

- Diezel: 7 – 8 lek/litër
- Eurodiezel: 10 – 12 lek/litër
- Benzinë: 5 – 6 lek/litër
- GLN: 8 – 10 lek / kg

Marzhi i fitimit per qarkullimin e karburantit deri te kosumatori eshte:

- Diezel: 10 – 12 lek/litër
- Eurodiezel: 14 – 17 lek/litër
- Benzinë: 10 – 12 lek/litër
- GLN: 12 – 15 lek / kg

Nese bejme llogaritjet per sasine e konsumuar, si me poshte ne 6 mujor, rezulton nje fitim per shumicen ne shumen 3,3 miliard leke, qe do te thote nje tatim fitimi per 330 milion leke. Nese e krahasojme me derdhjet e tatim fitimit per 6 mujorin kemi nje diference prej 100 milione leke. Natyrisht, qe keto llogaritje kane nevojë per saktësim nga kontrollet tatimore ne vend.

Konsumi i karburanteve në vend ka pësuar rritje gjatë 6 mujorit I 2010. Kjo pavarësisht tendencës rritëse të çmimit në tregun e shitjes me pakicë. Nga të dhënat e Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave rezulton se gjatë pjesës së parë të këtij viti janë zhdoganuar 26. 345 ton më shumë karburante se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në këtë 6-mujor janë zhdoganuar 220. 258 ton nga 193. 913 ton të zhdoganuara në të njëjtën periudhë të vitit 2009.

Çmimi i karburanteve ka shënuar rritje të vazhdueshme gjatë këtij viti. Ne muajin korrik 2010, në pikat e shitjes me pakicë të karburanteve, nafta ka arritur në 142 lekë për litër, nafta e cilësisë së mirë e njohur ndryshe si eurodizeli tregtohet me 146 lekë për litër, ndërsa benzina me 149 lekë për litër. Gjatë muajve të Korrik dhe Gusht, çmimi me pakice i karburanteve ka pësuar rritje. Kjo veçanërisht në zonat bregdetare ku konsumi në periudhën e verës rritet ndjeshëm. Eksperienca e deritanishme ka treguar se për shkak të turistëve dhe kthimit në atdhe të emigrantëve, çmimet në qytetet bregdetare jane rritur me rreth 5 lekë më shumë se në zonat e tjera të vendit, si pasojë e kërkesës së lartë.

Nese krahasojme me cmimet e karburanteve me pakice ne fund te 6 mujorit 2009, verehet se Euro Diesel eshte shitur me 130 leke me TVSH, Super plus eshte shitur me 130 leke me TVSH dhe Diesel me 126 leke me TVSH.

1.6. Energjitika

Aktualisht, janë në shfrytëzim 7 hidrocentrale të medhenj dhe 37 hidrocentrale të vegjël.

Në lumin Drin, janë në funksionim 3 hidrocentrale, me kapacitetet total të instaluar 1350 MË: HEC-i Vau i Dejës, HEC-i Fierza, HEC-i Koman. Aktualisht, është lidhur kontrata konçesionare për ndërtimin e hidrocentralit të Ashtës , mbi Lumin Drin, me kapacitet të instaluar 48.2 MË.

Në lumin Mat, janë në shfrytëzim HEC-i Ulëz dhe HEC-i Shkopet, me kapacitet total të instaluar 49 MË.

Në lumin Devoll, para vitit 1990, ka filluar ndërtimi i hidrocentralit të Banjës, me kapacitet të projektuar 60 MË. Aty janë kryer vetëm 40% e punimeve dhe është lënë pas dore.

Aktualisht, është fituar tenderi për marrjen me konçesion të kaskadës së hidrocentraleve mbi lumin Devoll.

Në lumin Vjosa, është duke u ndërtuar hidrocentrali i Kalivacit, me kapacitet të instaluar 90 MË.

Në lumin e Bistricës, janë në funksion hidrocentralet Bistrica I dhe Bistrica II, me kapacitet të instaluar 27,5 MË.

Me poshte eshte prezantuar cmimi i miratuar per 2010 dhe 2009, per shitjet me pakice

Niveli i tensionit	Kategoritë e konsumatorit	Diferenca 2010 me 2009		
		Çmimi 2010 (Lekë/këh)	Çmimi 2009 (Lekë/këh)	Diferenca (Lekë/këh)
Tension i lartë	Klientë të transmetimit TL me asete të zotëruar prej tyre			
	Industri	6.20	5.20	1.00
	Tregti & shërbime			
	Bujqësi			
	Të tjerë			
	Klientë të furnizuar në N/S 110 kV të shpërndarjes			

	Industri	8.00	7.00	1.00
	Tregti & shërbime	8.00	7.00	1.00
	Bujqësi	8.00	7.00	1.00
	Të tjerë	8.00	7.00	1.00
Tension i i mesëm	Klientë të furnizuar në 35 kV			
	Industri	8.50	7.50	1.00
	Tregti & shërbime	8.50	7.50	1.00
	Bujqësi	8.50	7.50	1.00
	Të tjerë	8.50	7.50	1.00
	Klientë të furnizuar në 20/10/6 kv			
	Industri	9.10	8.00	1.10
	Tregti & shërbime	10.00	8.50	1.50
	Furra buke, prodhim mielli	7.10	7.00	0.10
	Bujqësi	8.70	8.00	0.70
Të tjerë	9.70	8.00	1.70	
Buxhetorë	11.50	9.50	2.00	
	Klientë të furnizuar në TU			
	Industri	10.50	9.50	1.00
	Tregti & shërbime	12.20	10.00	2.20
	Furra buke, prodhim mielli	7.60	7.50	0.10
	Bujqësi	10.50	9.50	1.00
	Të tjerë	12.00	10.00	2.00
	Buxhetorë	14.00	12.00	2.00
	Familjarë			
	Blloku i parë deri në 300 këh	7.70	7.00	0.70
	Blloku i dytë mbi 300 këh	13.50	12.00	1.50
	Tarifa fikse e shërbimit për leximin “zero” (lekë/muaj)	200	200	0

	Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompë, ashensor, etj. (lekë/kËh)	8.00	7.00	1.00
	Mesatare totale	9.53	8.45	1.48

Ne 2009 është konsumuar nga familaret 2.4 GËh, ndersa sektori tjetër ka konsumuar 1.87 Gëh. Gjithsej është konsumuar 4.3 GËh.

Nga ndryshimi i cmimit midis 2010 me 2009 pritet të rritet efektin në të ardhura për 774 milion leke duke përfshirë gjithë detyrimet tatimore, që përfshin ky sistem.

1.7. Shërbimet e ndryshme

Në këtë sektor ka një rënie në 6 mujin e parë 2010 në krahasim me 2009 të shitjeve të tatueshme, që përgjithësisht vjen nga rënia e qarkullimit në shoqëritë e telefonisë celulare dhe shoqërive të sigurimit.

Ndër rrisjet për të ardhurat e buxhetit që kanë këto shoqëri janë:

Shoqëritë e shërbimeve të telekomunikacionit kanë probleme me:

- *shpenzimet për shërbime që kryejnë shoqëritë e huaja jorezidente të përegjistruara në Shqipëri. Këto shpenzime kapin vlera që arrijnë në shumën disa dhjetra milion Euro. Kompanitë kanë bërë trajtime të ndryshme tatimore lidhur me mënyrën e prezantimit të këtyre marrëdhënieve në shpenzimet e bilanceve të prezantuara në organet tatimore.*
- *dhenien e huave kompanive të grupit jashtë territorit të vendit tonë. Në këtë drejtim argumentimi dhe auditimi duhet të kryhet mbi standartet ndërkombëtare të kontabilitetit dhe duke shfrytëzuar literaturën dhe përvojën bashkëkohore për rastet analoge për trajtim korrekt duke u nisur nga përmbajtja e veprimit dhe jo vetëm nga veprimi, si rast i vecuar.*

1.7.1. Shoqerite e sigurimeve

Nese shikojme tabelen me poshte, vetem nga shoqerite e sigurimeve ka nje renie ne qarkullimin e tyre prej 87 milione leke, qe do te thote nje renie ne tatim fitimi me mbi 1 milione leke.


Primet e Shkruara Bruto dhe Dëmet e Paguara

Grupimi sipas Llojit	Vlera (në mijë lekë)		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010	`10/09 -1	2009	2010
Periudha Janar - Qershor					
Primi i Shkruar Bruto					
Aktiviteti i Jetës	339,683	366,112	7.78	8.36	9.21
Aktiviteti i Jo- Jetës	3,710,454	3,586,670	(3.34)	91.36	90.25
Veprimtaria e risigurimit	11,403	21,289	86.70	0.28	0.54
TOTAL	4,061,540	3,974,071	(2.15)	100.00	100.00
Dëme të Paguara Bruto					
Aktiviteti i Jetës	22,773	29,257	28	2.95	2.90
Aktiviteti i Jo- Jetës	749,846	978,707	30.52	97.05	97.09
Veprimtaria e risigurimit	-	120	-	-	0.01
TOTAL	772,618	1,008,084	30.48	100.00	100.00


Numri i Kontratave të Lidhura dhe Dëmeve të Paguara

Grupimi sipas Llojit	Nr. i kontratave		Ndryshimi (në %)	Pjesa ndaj Totalit (në %)	
	2009	2010	`10/09 -1	2009	2010
Periudha Janar - Qershor					
Numri i Kontratave					
Aktiviteti i Jetës	28,673	32,447	13.16	7.91	10.59
Aktiviteti i Jo- Jetës	333,774	274,054	(17.89)	92.09	89.41
Veprimtaria e risigurimit	-	-	-	-	-
TOTAL	362,447	306,501	(15.44)	100.00	100.00
Numri i Dëmeve të Paguara					
Aktiviteti i Jetës	31	35	13	0.52	0.47
Aktiviteti i Jo- Jetës	5,907	7,441	25.97	99.48	99.51
Veprimtaria e risigurimit	-	2	-	-	0.03
TOTAL	5,938	7,478	25.93	100.00	100.00

Primet e Shkruara Bruto



Dëmet e Paguara



1.7.1. Shërbimet e artit, argetimit

Nje tjetër drejtim që mbetet me kontribute të dobëta në të ardhurat tatimore janë kontributet e aktiviteteve të akomodimit, ushqimit dhe argetimit, si dhe kompanitë që janë pjesë e shfaqjeve argetuese të lidhura me të drejtën e autorit. Nuk ka një statistikë të plotë për këtë grup aktiviteti, por nga informacionet e medias dhe nga QKR mendohet që ky grup aktivitetsh në sektorin e shërbimeve të jetë i formal me një peshë sa 2% e gjithë regjistrit të bizneseve të vendit. Ndërsa ky treg gjeneron rreth 3% të PBB-së në kontributin në buxhet prurjet prej tij janë të papërfillshme. Ky sektor aktivitetsh mbetet më të shumtën e tij informal dhe pjesë e evazionit tatimor, me historik të tillë prej mbi 10 vitesh.

1.7.2. Shërbimet e turizmit

Në gjithë vendin sipas regjistrit informatik tatimor janë 758 tatimpaguese që janë me kodin ekonomik për aktivitete agjensi dhe turistike. Në këto tabelle nuk përfshihen njesitë akomoduese si hotele, bare, restorante dhe njesi të tjera argetuese dhe lojrash.

Pasqyra e agjensive që kryejnë aktivitetin e tyre në 12 qarqe, 2010

numer

Nr.	Qarku	Agjensitë e regjistruara si biznese sipas aktivitetit				Totali
		Turistike	Pasagjeresh	Doganore	Agjensi miks	
1	Berat	1	1			2
2	Diber	1	1		2	4
3	Durrës	43	113	84	24	264
4	Elbasan	2	12		4	18
5	Fier	3	9		5	17
6	Gjirokastër	1	1		1	3
7	Korçë	3	2		5	10
8	Kukës	3	3			6
9	Lezhë	5	5		1	11
10	Shkoder	17	13		6	36
11	Tiranë	205	41	13	86	345
12	Vlorë	18	15	8	3	44
Gjithsej		302	216	105	137	760

Burimi i informacionit : QKR, Ministria e Telekomunikacionit, AKT

Nisur nga evidentimi i bere ne vitin 2010, rezulton se shperndarja e njesive akomoduese janë:

- ***Shkodër.*** Ne bregdetin e Velipojës kryejne aktivitet ne fushen e sherbimit akomodues, te licensuar nga DRT 83 *tatimpaguesë*. Nga informacione te grumbulluara nga institucionet qe monitorojne turizmin dhe sipas te dhenave te publikuara nga nje studim i GTZ ne bashkepunim me komunitetin e bizneseve ne kete zone, rezultojne te kryejne aktivitet prane bregdetit 90 individe dhe janë kryesisht biznese me persona të familjes. Në këtë zone puna për informimin, regjistrimin dhe zbatimin e ligjit rezulton e pamjaftueshme, mjaft te shkohet me nje vezhgim te thjeshte.

- ***Lezhë.*** Në bregdetin e Shëngjinit kryejnë aktivitet në këtë zonë në akomodim dhe shërbime të tjera 60 *biznese të regjistruar*. Nga të dhënat për aktivitetet në zonën bregdetare Ishull – Shëngjin-Kunë-Vain rezultojnë të kryejne aktivitet 70 individë dhe biznese failjarë.

- ***Pogradec.*** Në këtë zonë turistike kryejnë aktivitet në akomodim 80 *biznese të regjistruar*. Nga informacionet e operatoreve turistike dhe vete pronaret e objekteve per qellime turistike, rezulton se në zonën turistike Drilon-Tushemisht puna e administrates fiskale lokale dhe qendrore duhet të organizohet në drejtim të regjistrimeve të aktiviteteve brenda ambjentit që kanë deklaruar vetëm një vend biznesi.

- ***Durrës.*** Në këtë zonë bregdetare të gjatë kryejnë aktivitete akomoduese dhe argëtuese 1,600 *biznese të regjistruara*. Nga informacione nga burime mediatike, buletine informative apo puna e institucioneve të punësimit rezulton se aktivitetet e paregjistruara dhe punesimi informal eshte ne nivelet me te ulta krahasuar me bregdetin e zonave te tjera te Shqiperise. Edhe në këtë zonë bregdetare puna administrates lokale dhe qendrore duhet të organizohet në drejtim të regjistrimeve të aktiviteteve brenda ambjentit që kanë deklaruar vetëm një vend biznesi, si dhe përdorim të faturave tatimore dhe kasës regjistruese. Kjo zonë bregdetare duhet përmendur se karakterizohet nga një aktivitet, që kryhet gjithë vitin dhe jo vetëm në sezonin e pushimeve verore, kur ka një dyndje pushuesish.

- ***Kavajë.*** Në zonën bregdetare të Golem-Mali i Robit-Spille kryejë aktivitet në fushën e akomodimit për pushuesit 130 *biznese të regjistruar*. Situata e administrimit ka ngjashmeri me

zonen e Durrësit Gjithsesi, vemendja duhet të përqëndrohet në bizneset familjare, të cilat kërkojnë një investigim të vazhdueshëm në terren, pasi ky rreth ka dhe pika të tjera turistike, përveç zonave të mësipërme.

- **Vlorë.** Në zonën bregdetare Vlorë-Radhimë-Orikum-Dhërmi-Himarë-Qeparo kryejnë aktivitet në fushën e akomodimit turistik *220 biznese të regjistruar*. Nëse shikojmë përhapjen e pikave turistike dhe numrin e të regjistruarve, të krahasuar me informacionet që vijnë nga burimet e medias ekonomike, informacioneve në rrugë operative rezulton se vetëm Bashkia Himarë ofron për pushuesit rreth 900 shtretër, kryesisht akomodime familjare të përshtatura për pushuesit, por që kanë kohëzgjatje për periudhën e muajve Korrik-Gusht. Të ardhurat përfitohen nga mjaft qytetarë, të cilët janë rezidentë në Greqi dhe kryejnë aktivitet sezonal në shtepite e tyre, të cilat i kanë përshtatur për dhoma për pushuesit vendas dhe të huaj.

Në këtë zonë bregdetare puna e administratës lokale dhe qendrore duhet të organizohet në drejtim të regjistrimeve të aktiviteteve brenda ambjentëve për banim apo atyre, që kryejnë dhe aktivitetin sezonal me të njëjtën çertifikatë tatimore të regjistruar për aktivitet tjetër, si dhe informimi për dokumentacionin fiskal që duhet të përdorin si dhe ushtrimi i masave shtërnguese për përdorim të faturave tatimore dhe kasës regjistruese, pavarësisht nga natyra sezonale e aktivitetit. Duhet futur edhe në zona informale për regjistrimin e aktiviteteve si: Jal, Bunec, Zvernec, Kondraqe dhe pika të reja në të cilat po bëhen investime për zgjerimin e shërbimeve turistike, si transporti dhe aktivitetet argetuese.

- **Sarandë.** Në brezin bregdetar Borsh-Sarandë-Ksamil kryejnë aktivitet për qëllime turistike *110 biznese të regjistruara*. Një pjesë e bizneseve zhvillojnë aktivitet sezonal turistik, qeradhenie ambjentesh familjare vetëm gjatë periudhës së verës, kryesisht në formë strehimi për pushuesit për këtë periudhë. Sipas informacioneve të grumbulluara rezulton një evazion afër 3,000 shtretër duke marrë në konsideratë studime të OJF-ve në terren. Edhe në këtë zonë bregdetare problematikat janë të ngjashme me zonën bregdetare të Vlores dhe gjithë Shqipërisë.

Vecanti në këtë pjesë të bregdetit përben fakti i të punësuarve sezonale, që nuk janë të regjistruar në sigurimet shoqërore, pasi punojnë këtu vetëm për rreth 60-80 ditë pune. Mbi këtë bazë masat shtërnguese po përdoren për llogaritjen dhe arkitimin e kontributeve, për

kohen që punojnë, pavarësisht se mund të mos jenë “pjesë permanente” e skemës së Sigurimeve Shoqërore.

Sipas burimeve të Shoqatës Shqiptare të Turizmit në vend ka rreth 600 hotele ose 900 njësi akomoduese (hotele, apartamente pushimi, motele etj) me rreth 30 000 shtretër. Nëse 2/3 nga këto do të kalojnë bregdetit do të thotë që janë rreth 20 000 shtretër. Pra kapaciteti maksimal i bregdetit tonë mund të mbajë në një ditë deri në 20 000 turistë. Sezoni turistik i plazhit ka një shtrirje afërsisht 2 muaj, kohë kur vijnë edhe numri më i madh i pushuesve. Po të konsiderojmë një qëndrim mesatar gjatë kësaj kohe rreth 5 netë, do të thotë që gjatë një muaji akomodohen maksimumi 120 000 turistë. Në 2-3 muaj kjo shifër bëhet rreth 300 000 turistë.

Me një numër rreth 30 000 pushuesish në 2-3 muajt e verës, shqiptarët mund të jenë në vend të parë në përqindje për numër të popullsisë nga vendet e Mesdheut, që kalojnë pushimet në Turqi, pra në një vend tjetër po Mesdhetar. Dhe të mos harrojmë se ky treg prej 30 000 vetash që kërkon plazhe të huaja për të kaluar pushimet e tyre dhe shpenzon rreth 700-1000 Euro për person gjatë 1 jave apo 10 ditësh.

Cmimet e ambjenteve të pushimit në bregdetin shqiptar dhe zonat e tjera turistike variojnë nga 20 euro deri 80 euro në ditë.

1.7.2.1. Agjensitë e udhëtimit, turistike dhe speditonere

Në tregun shqiptar operojnë ndërkohë mbi 500 *Agjensi turistike dhe shitje biletash*, të cilat janë pjesë e verifikimit për licencën profesionale nga MPPT. Edhe në këto agjensi nga ana jone duhen ushtruar verifikime dhe kontrole për paketat turistike për udhëtimet carter jashtë vendit si një biznes i rritur nga njëri vit në tjetrin. Një problem mjaft i mprehtë është dokumentimi i punës që kryejnë për dergesat e turistave shqiptarë në shtetet e huaja. Në këto rast ato lluajnë rolin e agjentit shites në emër të kompanive të huaja dhe sistemi i dokumentimit që ato zbatojnë nuk përputhet me atë që duhet të bëjnë sipas ligjit të procedurave tatimore. E njëjta dukuri është edhe për agjensitë e biletave të udhëtarëve dhe speditonere.

Nëse midis kompanive ajrore dhe agjencive të udhëtimit në vend është vendosur një pozitë monopol, përse i përket çmimit të shtrenjtë të biletave të udhëtimit. Tregu i fluturimeve ajrore në Shqipëri shënon më shumë se 1.5 milionë klientë gjatë vitit të kaluar. Xhiroja totale vlerësohet me mbi 350 milionë euro në vit. Tregu i fluturimeve ajrore ka qenë i prekur nga monopoli, për shkak se fluturimet ndërkombëtare rregullohen përmes marrëveshjeve dypalëshe të komplikuara dhe të kushtueshme. Kështu, nëse një kompani italiane vendos të udhëtojë drejt Tiranës, një kompani shqiptare duhet të kryejë të njëjtin numër fluturimesh. Por gjatë viteve të fundit, BE-ja dhe SHBA-të kanë punuar për liberalizimin e këtij tregu, duke hequr kufizimet ligjore të reciprocitetit dhe duke ulur çmimet.

Keto shërbime në zerin e të ardhurave tatimore futen të shërbimet e tjera. Kontributi i këtij sektori, ku përfshihen edhe shërbime të tjera përveç tyre ka një peshë sa 1% e të ardhurave tatimore gjithsej.

1.8. Transporti i mallrave dhe udhëtarëve

Kompanitë më të shumta të lundrimit operojnë në linjën Durrës-Bari dhe anasjelltas. Aktualisht në treg, në këtë linjë, operojnë 5 kompani, të cilat janë: “Tirrenia”, “Ventouris Ferries”, “Ilion Lines”, “Adria Ferries” dhe “European Seaëay”. Në lidhje me linjat e tjera që lidhin portin e Durrësit me portet e Triestes dhe Ankonës, operojnë kompani të vetme që janë monopol në këto linja. Në linjën Durrës-Trieste operon kompania “Ilion Lines”, kurse në linjën Durrës-Ankona është kompania “Adria Ferries”. Shumica e kompanive të mësipërme janë greke, por çmimi i biletës për kamionët dhe trailerët është vendosur i njëjtë, duke shmangur në këtë mënyrë konkurrencën.

Në linjën Durrës-Bari një kompani aplikon këto çmime: kabinë klasi A 54 euro, kabinë klasi B 47 euro, kabinë klasi C 43,5 euro, vend i ulur në poltron 40 euro, vend qëndrimi në këmbë 31.5 euro, ndërsa bileta për autoveturën 36.5 euro. Një tjetër kompani për të njëjtën linjë aplikon çmime të ndryshme: kabinë klasi A 59 euro, kabinë klasi B 48.3 euro, kabinë klasi C 40.6 euro, vend i ulur në poltron 30.1 euro, vend qëndrimi në këmbë 25.9 euro, kurse bileta për autoveturën është 46.5 euro. Në lidhje me linjën Durrës-Trieste çmimet janë pothuajse të dyfishuara për shkak të distancës më të madhe: kabinë klasi A 133 euro, kabinë klasi B 133

euro, kabinë klasi C 113 euro, vend i ulur në poltron 93 euro, vend qëndrimi në këmbë 83 euro, ndërsa bileta për autoveturën kushton 125 euro.

Kompanitë kanë llogaritur që për një metër linear gjatësi të kamionit të vlerësohet me çmimin 22 euro linja Bari-Durrës dhe anasjelltas.

Rritja me 60 për qind e biletës gusht 2010 bëhet në mënyrë spekulative. Një biletë për qëndrim në këmbë në traget do të kushtojë 64 euro, mjeti për t'u transportuar do të paguajë 80-100 euro, rezervimi për një shtrat të thjeshtë 74 euro, shtrati i klasit të parë kushton 94 euro dhe prenotimi i një dhome suite është bërë 115 euro. Vetëm një vit më parë bileta në këmbë me traget kushtonte 38 euro dhe rritja e saj me 26 euro është cilësuar më së shumti spekulim.

Kompanitë e trageteve janë italiane e shqiptare, ndërsa në vendin tonë operojnë përfaqësitë si "Kad", "Duni", "Adria", "San Nikolla", "European Seas", "Rigel", të cilat janë të detyruara vetëm të bëjnë transportin pa pasur asnjë të drejtë të ndikojnë në çmimet e biletës për udhëtarë, mjete, kamionë, nese mund te shikohen edhe nepermjet listes me poshte:

Linja Durrës-Bari (Itali)

Të rritur	Fëmijë	Automjetet	Motorët
45 euro	24 euro	81 euro	66,50 euro

Linja Bari-Durrës

Të rritur	Fëmijë	Automjetet	Motorët
45 euro	24 euro	112,50 euro 6	8,50 euro

Edhe pse ky sektor nuk ka numer te konsiderueshem tatimpaguesish te regjistruar, nga eksperiencia dhe pervoja personale ne lidhje me analizen e treguesve tatimore te sektoreve ekonomike mendoj se kerkohet pune investigative dhe kontrolle me punonjes te specializuar per transportin e mallrave dhe udhetareve.

1.9 Tregtia

Megjithese tregtia ne pergjithesine e saj ka shenuar tregues ne rritje ne vetedeklarimet e tatimpaguesve te ketij sektori kontributi ne te ardhurat tatimore ze vetem 13 % te TVSH se paguar, 20% te tatimi mbi fitimin, si dhe 6 % te tatimit te ardhurave personale. Nese nisemi nga

krahasimi i peshes si numer tatimpaguesish me 43% te gjithë numrit dhe krahasuar me peshën që ze në të ardhurat tatimore, rezultojnë një diferencë e konsiderueshme dhe një sfidë për administratën fiskale. Ky sektor ekonomik mbetet orientimi më i madh për rezervat në të ardhurat tatimore. Konkretisht, kategoritë kryesore janë mallrat bazë të akcizueshme dhe ato kozmetike e farmaceutike.

Më pas është prezantuar lista me disa nga cmimet e shitjes që shiten në treg në 6 muajt e parë të 2009. Përveç kafesë kanë pësuar këto mallra ulje në 6 muajt e parë të 2010 me një nivel 0.2% në raport me 2009. Nga krahasimi i të dhënave të DPD për produktet e këtyre mallrave të importuara, rezultojnë se marzhi i fitimit për gjithë zinxhirin e qarkullimit import deri te konsumatori final është 15 deri 45 % fitim neto.

Cmimet e disa produkteve të konsumit në fundin e 6 muajit 2009.

Nr	Emertimi	Cmimet* e mallrave nga Importi		Cmimet e mallrave nga Prodhimi në vend	
		min.	maks.	min.	maks.
1	Makarona	100	140	100	140
2	Miell	39	41	44	51
3	Kafe jo e pjekur	350	550		
4	Sheqer	87	90		
5	Oriz	101	104		
6	Veze			7.5	8.5

**cmimet janë për njësi ku përfshihet edhe TVSH*

Në kategorinë e “fruta e perime” cmimet kanë shënuar një rënie mesatare prej 20 për qind në fund të 6 muajit të 2010. Norma mesatare e fitimit për këtë grup produktesh është nga 20% deri 40% fitim neto.

Cmimet e barnave në 2010 kanë pësuar një ulje nga 10 deri 25 përqind në raport me vitin 2009, sipas burimit të informacionit nga Ministria e Shëndetësisë. Megjithatë këto elemente në treg nuk kanë rënie të cmimeve të shitjes, fakt që duhet marrë në konsideratë për rilogaritje të tatimit mbi fitimin, si dhe kërkesën për tatimet e tjera, si ato mbi dividendin etj.

Rritja e akcizës për 55 produkte që janë tregë pritë të rrisin cmimet direkte të këtyre mallrave si dhe ndikimin indirekt në shërbimet që prekë nga to, si: transporti, prodhimet e lidhura me karburantin. Kështu çmimi i naftës do të rritet me 50 lekë për litër. Nga 150 lekë që është tani në tregun vendas nafta pritë të arrijë në deri në 200 lekë për litër. Një kategori tjetër që do të prekë nga rritja e ndjeshme dhe e menjëhershme e çmimeve janë grupi i duhanit. Kështu çdo paketë që gjendet në treg do të rritet me 50 lekë për copë. Rritja do të prekë edhe kafënë. Një kilogram kafe e pjekur nga 700 lekë që gjendet aktualisht në treg do të shitet me 840 lekë për kilogram nga 10 qershorit. Sipas një studimi të kryer nga shoqata e konsumatoreve shqiptare cmimet pritë të këne tendencën sipas tabelës me poshtë:

Tendencat e çmimeve si rrjedhojë e ndryshimit të akcizës 2010

ne leke

Nr.	Emertimi	Cmimi 6 muj.I 2010	Cmimi 6 muj.II 2010	Ndryshimi
1	Kafe jo e pjekur (leke/kg)	500	530	30
2	Kafe e pjekur (leke/kg)	700	840	140
3	Eksrakt kafeje (leke/kg)	1200	1250	50
4	Raki (leke/liter)	700	800	100
5	Pije alkoolike >12% alkool	220 leke mbi çmimin aktual		
6	Pakete cigare	150	200	50
7	Naftë virgin (leke/liter)	150	200	50
8	Hidrokarbure aciklike (leke/liter)	300	337	37
9	Preparate për lubrifikant (leke/kg)	3000	3040	40

2. Eksportuesit

2.7. Struktura dhe pjesemarrja ne treg

Ne pasqyren me poshte jane prezantuar shperndarja e eksportuesve sipas aktivitetit.

Lista e tatimpaguesve qe kane kryer eksporte ne 2009 dhe 2010			
Nr	Aktiviteti sipas kodit ekonomik	Numri tatimpaguesve	Ne % me totalin
1	Bujqesia, gjuetia dhe silvikultura	31	1.8%
2	Industria nxjerrrese	46	2.7%
3	Industria perpunuese	45	2.6%
4	Industria tekstile dhe e veshjeve	176	10.2%
5	Industria e lekures dhe kepuceve	60	3.5%
6	Punimet me dru dhe fabrikimi i tyre	30	1.7%
7	Fabrikimi i letres	36	2.1%
8	Industria kimike	21	1.2%
9	Industria e gomes dhe plastikes	20	1.2%
10	Fabrikimi i artikujve minerale jometalike	56	3.2%
11	Metalurgjia dhe punimi i metaleve	48	2.8%
12	Fabrikimi i makinave dhe paisjeve	11	0.6%
13	Fabrikimi i makinave dhe paisjeve elektrike	9	0.5%
14	Fabrikimi i mjeteve te transportit dhe paisjeve per to	17	1.0%
15	Fabrikimi i mobiljeve	40	2.3%
16	Prodhimi dhe shperndarja e energjise elektrike, e gazit, e avullit dhe e ujit te ngrohte	8	0.5%
17	Ndertim	100	5.8%
18	Tregtimi, mirembajtja dhe riparimi i automobilëve dhe motoçikletave	41	2.4%
19	Tregtia me shumice dhe ndermjetesimit tregtar (pervec mjeteve te transportit automobilistik)	480	27.8%
20	Tregti e ushqimeve, produkteve farmaceutike	117	6.8%
21	Sherbime transporti, agjenti turistik	165	9.6%
22	Sherbime telekomunikacioni	26	1.5%
23	Sherbime siguracioni	9	0.5%
24	Aktivitete informatike	34	2.0%
25	Aktivitete konsulence te ndryshme	57	3.3%
26	Aktivitete te karakterit social dhe jofitimpruese	13	0.8%
27	Aktivitete defrimi, kulturore dhe sportive	10	0.6%
	Aktivitete kulturore	9	0.5%
	Aktivitete pastrim kimik e sherbime personale	9	0.5%
Totali i eskportuesve		1724	100%

Burimi: Drejtoria e Menaxhimit te Ardhurave, Perpunimit dhe Rimbursimit

Konkluzione

Edhe pse burimet natyrore dhe përdorimi i tyre ka qene ne funksion te zhvillimit te ekonomise, si dhe zhvillimet e sektorëve ekonomikë qe kane pesuar ndryshime strukturore te vazhdueshme duke ja lene vendin njeri-tjeteri mund te thuhet se monitorimi fiskal dhe produktiviteti tatimor nuk ka ndjekur tendencen e zhvillimeve ekonomike.

Pesha e secilit prej sektorëve, grup aktiviteve apo aktiviteve te caktuara kanë qenë në një periudhë për të cilën duhet të ndihet si kontribues modestë në detyrimin e tyre për zhvillimin e vendit neëpërmjet kontributit fiskal.

Taksat janë thelbësore për zhvillimin e qëndrueshëm, legjitimitetin e shtetit, stabilitetin ekonomik, dhe financimin e shërbimeve publike dhe infrastrukturës.

Mospagimi i tyre nga secili shtetas, sipas detyrimit që i ka përcaktuar ligji krijon premisat për pengimin e ecjes përpara të ekonomisë. Edhe pse transparencja e realizimit të buxhetit nuk është bërë një rutinë në shoqërinë shqiptare nga ky dokument, por edhe nga të tjerë të ngjashëm ka mundësi që konkluzioni të jetë i njëjtë. Më pak tatime të mbledhura është një shpenzim më pak për të mirën publike, dhe në versionin e keq një deficit buxhetor, që i shtohet barrës së brezit të sotëm dhe të ardhëm në formën e borxhit.

Financimi i defiçitit jep efektin e shtyrjes se tij për të ardhmen duke mos renduar kështu vetem mbi qytetaret e sotem, por dhe për qytetaret e ardhshem. Megjithate, duke vërejtur praktiken boterore për këtë fenomen mund të thuhet se zhvendosja e borxhit në të ardhmen është i kushtezuar nga realitete financiare dhe ekonomike specifike. Nëse brezi i sotëm arrin t'u lere pasardhese të tij, apo femijeve të sotëm shume asete publike dhe sisteme të forta edukimi dhe shendeti, atehere mund të themi se u brezave të ardhshem u është dhene stafeta e një potenciali prodhues të larte. Nga ana tjetër nëse do t'u lihen me pak dhe me shume bono qeveritare atehere dhe potenciali prodhues do të zvogelohet.

Dhe duke u kthyer te administrimi fiskal te te ardhurave, pasi zotesia e qeverisjes nuk eshte shkurtimi i shpenzimeve, por rritja e te ardhurave nepermjet kerkeses per shtim shpenzimesh duhet kaluar permes analizave te pengesave per te depertuar ne brendine e rrisqeve. Zgjidhja dhe angazhimi per te kapercyer rrisqet do te ishte mundesia per te zhvilluar agjensi te forte te ardhurash.

Agjensite e te ardhurave fiskale kane qene subjekt i disa lloj vështirësive, veçanërisht për shkak të:

- brishtësisë se strukturave ekonomike dhe nivelit te ulët te konkurrencës;
- paqëndrueshmërisë politike, qeverisjes së keqe dhe dobësisë se sundimit të ligjit;
- Menaxhimit te keq te taksave dhe shpërndarjes jo të barabartë te barrës tatimore midis tatimpaguesve;
- dobësive të administratës tatimore qe lidhen me mungesën e mjeteve dhe aftësive.

Për të kapercyer këto vështirësi te reformës se taksave, hartuesit e politikave fiskale dhe ideuesit e administrimit duhet të mendohen me mire si të:

- shpërndajnë barrën e taksave në mënyrë të drejtë, sidomos duke balancuar tatimet direkte dhe indirekte;
- marrin parasysh natyrën specifike të ekonomisë informale (dmth. veprimtarite ekonomike te paregjistruara) dhe të mbështetin te vetepunesuarit dhe bizneset e vogla;
- mbajne dhe stabilizojnë kuadrin ligjor dhe të përmirësojnë transparencën e sistemeve të taksave;
- rritin aftësitë dhe kapacitetet e administratat ne mbledhjen e taksave dhe të raportimit të shpenzimeve.

Tirane, Dhjetor 2011